



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:288463

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06380072

C.nr.1819/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V. M. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Festim Shala, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i pagës së 13-të, jashtë seancës gjyqësore, me datë 30.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit V. M. nga M.,
- II. OBLIGOHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë paditësin t'a kompensoj si në vijim:
 - Në emër të pagës së fundvitit për vitin ..., në shumë prej ...€ (p...);
 - Në emër të pagës së fundvitit për vitin ..., në shumë ...€ (...; dhe
 - Në emër të pagës së fundvitit për vitin ..., në shumë prej ...€ (...; në shumë të përgjithshme prej ...€ (...), me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë më datë ..., e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej ...€ (...), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi V. M. nga M., me datë ..., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës ... në të cilën ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, dhe se duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, të datës 14.11.2018, neni 29, duke qenë se deri në këtë kohë e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj tij, ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën që në emër të pagave të fundvitit për vitet ...,, paditësit t'ia kompensoj shumën prej ...€ për secilin vit apo në total shumën prej ...€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, e duke u tërhequr nga kërkesa për kompensimin e shujtës ditore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumën prej ...€, dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej ...€.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, por e ka kontestuar në tërësi kërkespadinë e paditësit, me arsyetimin se ky kompensim nuk është realizuar për asnjë punonjës të policisë për shkak të mungesës së mjeteve financiare, pastaj se pasi që Ministria e Financave nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë këtu edhe nenin 29 par.2 të UA Nr.02/2008 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore nuk ka mundur të realizohet paga e 13-të. Poashtu ka theksuar se me nenin 30 paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, është paraparë se ky shpërblim do të realizohet vetëm nëse ka mjete buxhetore, pastaj ka theksuar se kërkesa e paditësit është përfshirë në parashkrim, sa i përket kamatës ka theksuar se paditësit nuk i është shkaktuar dëm përderisa i njëjti ka gëzuar të drejtën e pagës, pushimeve javore, mjekësore e vjetore dhe të drejtat tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, dhe në fund i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar. Përgjigjes në padi i ka bashkangjitur disa email-e të shkëmbyera në mes të paditurës dhe përfaqësueses së saj, ku janë kërkuar të dhënat sa i përket statusit disiplinor të paditësit dhe vlerësimi i performancës për të cilin paditësi ka kërkuar kompensimin.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar këto prova: vërtetimin e punësimit me nr.të referencës ... i datës ..., kërkesën e datës ..., kontratën e punës për paditësin me nr.reference ... të datës ... formularët e vlerësimit të performancës për paditësin për vitet ..., ... dhe ..., dhe email-e të shkëmbyera në mes të paditurës dhe këtu përfaqësueses së saj.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të LPK-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, për çka edhe të njëjtën e aprovoi në tërësi si të bazuar.

Gjykata gjen se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura por kontestues ishte fakti se atij i takon kompensimi në emër të pagës së 13-të, respektivish provueshmëria se atij i takon një kompensim i tillë.

Nga vërtetimi i punësimit me nr.të referencës ... i datës ..., gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data .. dhe se i njëjti realizon pagë mujore në lartësi prej ...€.

Nga kërkesa e datës ... gjykata vërtetoi faktin se paditësi ndër të tjera te e paditura ka paraqitur kërkesë për kompensimin e pagës së 13-të.

Nga kontrata e punës për paditësin me nr.reference ... i datës ..., gjykata vërtetoi se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën.

Me leximin e formularëve të vlerësimit të performancës për paditësin për vitet ..., ... dhe ..., gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur performancë pozitive gjatë këtyre viteve.

Nga email-e të shkëmbyera në mes të paditurës dhe përfaqësueses së saj, rezulton se ndaj paditësi nuk ka pasur masë disiplinore gjatë periudhës për të cilën i njëjti ka kërkuar kompensimin në emër të pagës së .. dhe se i njëjti përgjatë kësaj periudhe kohore ka pasur performancë të kënaqshme te e paditura.

Provave të lartcekura gjykata i'u fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa*

të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se me dispozitën e nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit.”*, ndërsa me dispozitën e nenit 30 paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, parashihet që *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.*

Zbatimi i Udhëzimit të lartëcekur, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 213/2023 të datës 09.10.2023.

Në kuptim të nenit 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në të cilin parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës. Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, vërtetoi se paditësi gjatë periudhës kohore ..., ... dhe ... ka marrë vlerësim të kënaqshëm nga e paditura dhe nuk ka qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore gjatë këtyre viteve andaj sipas dispozitës së nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës dhe nenit 30 paragrafi 2 Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të njëjtit i takon shpërblimi i një page ekuivalente me pagën e rregullt mujore të vitit përkatës.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata mori parasysh vërtetimin e punësimit, të lëshuar nga e paditura, nga i cili u vërtetua se paga e rregullt mujore e paditësit ka qenë në lartësi prej

...€, ndërsa për tre vite të njëjtit i takon shuma në lartësi prej ...€, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Lidhur me lartësinë e kamatës, gjykata vendosi në bazë të dispozitës së nenit 382 të LMD-së, e cila përcakton se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë më datë 22.12.2021.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në dispozitën e nenit 452 të LPK-së, për arsye se pala e paditur duke qenë se e ka humbur kontestin ka për obligim që palës paditëse t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej ...€ (e paraparë sipas Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, Nr.Tarifor 6 dhe 17), dhe taksës gjyqësore për padi në shumë prej ...€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh edhe pretendimin e të paditurës se kjo e fundit nuk ka mjete buxhetore për kompensimin e kërkesës së paditësit dhe gjeti se neni 29 par.2 i Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, ka qenë në fuqi deri më datë 29.09.2021, i njëjti ka qenë i karakterit detyrues, dhe sipas të njëjtit punëdhënësi ka qenë i obliguar që të planifikojë mjetet buxhetore, andaj edhe është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit dhe gjeti se paditësi kompensimin në emër të pagës së fundvitit e ka kërkuar për vitet, dhe ..., ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtruar më datë ..., e duke qenë se e drejta për kompensimin e pagës së 13-të, për paditësin ka lindur në fund të vitit për të cilin ka kërkuar kompensimin, rezulton se kërkesa e tij është parashtruar brenda afatit 3 (tre) vjeçar ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës të Kosovës.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e të paditurës se me nenin 30 paragrafi 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, është paraparë se ky shpërblim do të realizohet vetëm nëse ka mjete buxhetore, dhe gjeti se në rastin konkret barra e të provuarit për mungesën e mjeteve buxhetore

i takon të paditurës dhe duke qenë se e njëjta me rastin e dhënies së mundësisë nga gjykata për tu deklaruar lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, pretendimet e veta, në rastin konkret pretendimin për mungesë të mjeteve financiare nuk e ka provuar me asnjë provë, ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 7 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*, gjykata vlerësoi se një pretendim i tillë nuk qëndron.

Nga sa u tha më lart, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1819/2021, më datë 30.10.2024

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.